

# RAPORTI I *monitorimit* PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

## Raporti numër 1

(periudha e raportimit:  
nëntor 2016 – janar 2017)

Shkup, Shkurt 2017

**Projekti:**

Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

**Implementues:**

Instituti për të Drejtat e Njeriut



British Embassy  
Skopje

Hartimi i këtij publikimi është në kuadër të Projektit “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë” i mbështetur nga Ambasada e Britanisë në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë publikim i pasqyrojnë opinionet dhe qëndrimet e autorëve.

## Përmbajtja

Hyrje.....	4
<b>TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM.....</b>	<b>5</b>
Ueb lokacioni informativ i Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë.....	5
Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë.....	6
Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve _ .....	7
Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM.....	7
<b>EFEKTIVITETI NË PUNËN E KGJRM .....</b>	<b>8</b>
Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve .....	8
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave .....	8
Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave .....	9
Zgjedhja e gjyqtarëve porotë.....	9
Referimi i përkohshëm i gjyqtarëve .....	10
<b>TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT .....</b>	<b>10</b>
Ueb lokacioni informativ i Këshillit të Fakteve dhe sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë .....	10
Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë .....	10
<b>EFEKTIVITETI NË PUNËN E KËSHILLIT TË FAKTEVE .....</b>	<b>11</b>
Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura .....	11
Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit pranë Këshillit të Fakteve.....	11

## Hyrje

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë (KGJRM) është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit, i cili ka rëndësi të veçantë në sigurimin dhe garantimin e pavarësisë dhe mëvetësisë së pushtetit gjyqësor përmes realizimit të funksioneve të veta. Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve) u themelua në vitin 2015 si organ i cili pranon iniciativa dhe paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës pranë Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.<sup>1</sup>

Instituti për të Drejtat e Njeriut e ndjek rregullisht punën e këtyre dy organeve, aktualisht si pjesë e Projektit “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM” që zbatohet brenda periudhës kohore nga muaji shtator i vitit 2016 deri në muajin mars të vitit 2018, i cili mbështetet nga Ambasada e Britanisë në Shkup.<sup>2</sup>

Ky është Raporti i parë i monitorimit në kuadër të Projektit, i cili e përfshin periudhën kohore nga muaji nëntor i vitit 2016 deri në muajin janar të vitit 2017. Raporti i monitorimit për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor të RM dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit është hartuar në bazë të Matricës së monitorimit me indikatorë të përcaktuar.

Transparenca e Këshillit Gjyqësor të RM dhe Këshillit të Fakteve në periudhën e monitorimit, *1 nëntor 2016 deri 31 janar të vitit 2017*, u monitorua nga aspekti i informimit përmes faqes së internetit, llogaridhënies së siguruar ndaj publikut të gjerë përmes mënyrave të ndryshme të informimit, si dhe përmes transparencës së siguruar të mbledhjeve.

Efektiviteti i punës së këtyre dy organeve u monitorua përmes realizimit të kompetencave të cilat këto organe i posedojnë konform ligjit. Informacionet të cilat janë pjesë të këtij Raporti janë siguruar përmes monitorimit të rregullt të të gjitha mbledhjeve të Këshillit Gjyqësor dhe përmes informacioneve të aksesshme në faqen e internetit, ndërsa informacionet për Këshillin e Fakteve janë siguruar përmes qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik.

1 Më shumë informacione për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Fakteve, si dhe sqarime më të detajuara për kompetencat e tyre ligjore janë të aksesshme në “Analiza themelore për punën e Këshillit Gjyqësor të RM”. I aksesshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=124>.

2 Më shumë informacione për aktivitetet e Projektit janë të aksesshme në faqen e internetit të Institutit për të Drejtat e Njeriut - [www.ihr.org.mk](http://www.ihr.org.mk) si dhe përmes aplikacionit mobil „Судски совети Уог луџа” i aksesshëm në Google Play dhe Apple Store.

# TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

√ = e plotësuar  
 x = e pa plotësuar  
 √ x = pjesërisht e plotësuar

## Ueb lokacioni informativ i Këshillit Gjyqësor të RM dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Ueb lokacioni informativ i Këshillit Gjyqësor					
Karakteristika të përgjithshme	Vizibil	I lehtë për navigacion	Përplot me të dhëna relevante	I sistematizuar	I thjeshtë për kërkim
Ueb faqja e Këshillit Gjyqësor të RM është <a href="http://www.ssrn.com.mk">www.ssrn.com.mk</a> . Informacionet publikohen edhe në ueb faqen e re <a href="http://www.sud.mk">www.sud.mk</a> e cila në të ardhmen duhet ta zëvendësoj ueb faqen e vjetër dhe të paraqesë platformë të integruar për gjyqësorin.	√	√	√x	√ x	√ x
Akte të cilat publikohen	Publikimi në kohë	Arkiv i aksesshëm (i lehtë për përdorim dhe kërkim)	Përditësimi i të dhënave	Akte/të dhëna të publikuara integrale	Vërejte të përgjithshme
Vendime	x	√	x	X	Vendimet nuk publikohen rregullisht në faqen e internetit
Procesverbale	x	X	x	X	Procesverbalet e mbledhjeve nuk publikohen.
Njoftime për mbledhjet e konvokuara	√	√	√	√	Rregullisht publikohen njoftime për mbledhjet e konvokuara (2-3 ditë) para mbledhjes
Prokurime publike, informacione për publikun	√x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor ka publikuar listë me prokurime publike të zbatuara për vitin 2016, edhe atë në datë 06.12.2016. Megjithatë, ky dokument është vendosur në pjesën Njoftime dhe i njëjti nuk është lehtë i aksesshëm.
Raporte vjetore të Këshillit Gjyqësor	√x	√	√	√	Këshilli Gjyqësor me vonesë e miratoi Raportin e punës për vitin 2015.
Raporte tremujore për punën e gjykatave në RM	x	x	x	x	Këshilli Gjyqësor rregullisht, në çdo tre muaj, i harton raportet tremujore. Megjithatë, të njëjtat aktualisht nuk janë të aksesshme në faqen e internetit edhe pse është siguruar një fushë për këtë dedikim.

## Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë			
	A ka KGJRM rregulla për komunikim me publikun		A ka person të angazhuar t'u përgjigjet kërkesave sipas qasjes së lirë deri te informacionet
	√		√
Informimi proaktiv i publikut	Të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor	Publikime të shpeshtuara	Vërejtje të përgjithshme
Pres konferenca	x	x	Në këtë periudhë Këshilli Gjyqësor nuk ka mbajtur pres konferenca
Njoftime	√	1-2 në javë	Më së shpeshti njoftimet kanë të bëjnë me mbajtjen e mbledhjeve.
Intervista	x	/	Kryetari i Këshillit Gjyqësor ishte i pranishëm në disa debate dhe emisione televizive.
Deklarata	x	1-2 në javë	Si praktikë e re pas mbledhjeve, nëse ka gazetarë, Kryetari i KGJRM jep deklaratë dhe përgjigjet në pyetjet e gazetarëve.

Këshilli Gjyqësor rregullisht e përditëson faqen e internetit përmes publikimeve dhe njoftimeve për mbajtjen e mbledhjeve, njoftimeve për konkluzionet nga mbledhjet dhe përmes njoftimeve për takimet e mbajtura në vend dhe jashtë vendit.

Faqja e re e internetit është e lehtë për kërkim dhe përmban informacione për aktivitetet e rregullta të Kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit Gjyqësor, si dhe raporte vjetore për punën e Këshillit Gjyqësor.

Megjithatë, fushat e raporteve tremujore për punën e gjykatave, prokurimeve publike dhe informacione për publikun fare nuk janë plotësuar, këto informacione nuk janë përditësuar as në ueb faqen e vjetër.

Këshilli Gjyqësor i RM nuk e publikon programin e punës, strategjitë, qëndrimet, opinionet, studimet dhe dokumentet e tjera të ngjashme.

Ekzistimi i **dy ueb faqeve paralele** krijon konfuzion për shkak të njoftimit të pamjaftueshëm të publikut me faqen e re, ndërsa faqja e vjetër nuk përditësohet konform ndryshimeve ligjore.

## Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve

Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve			
Transparenca e mbledhjeve	Numri i mbledhjeve të mbajtura	Pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit	Rrethanat kur është përjashtuar publiku
Nëntor	3	Shqyrtimi i raporteve tremujore të gjykatave; Miratimi i Rregullores për ngritjen dhe përcaktimin e humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, pastaj miratimi i vendimeve për referimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetër.	Vlerësimi i jashtëzakonshëm i kandidatëve për kryetarë të GJSRM, Gjykatës Themelore Shkup 1, Gjykatës së Apelit Shtip dhe Gjykatës Themelore Tetovë
Dhjetor	3	Zgjedhja e kryetarëve UD në GJSRM dhe Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup; Miratimi i Vendimit për referim të përkohshëm të gjyqtarëve.	Vlerësim i jashtëzakonshëm i punës së gjyqtarëve – kandidatë për kryetar për vitin 2015 dhe 2016.
Janar	2	Miratimi i Orarit të punës të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017; Miratimi i Programit për mbështetjen e ndërmjetësimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrtimi dhe vendimmarrja ndaj kërkesave të paraqitura për rivlerësimin e punës së gjyqtarëve – kandidatë për kryetarë për vitin 2015 dhe 2016.</li> <li>- Përcaktimi i raportuesve nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor sipas kërkesave të paraqitura për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit nga Këshilli i Fakteve.</li> </ul>

Në periudhën kohore nga muaji nëntor i vitit 2016 deri në muajin janar të vitit 2017 Këshilli Gjyqësor mbajti gjithsej 8 mbledhje.

Në këtë periudhë kohore kemi numër më të madh të pikave të shqyrtuara të cilat nuk ishin të hapura për publikun.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor, në këtë periudhë, kishte numër të rritur të deklaratave për media, por në pyetjet lidhur me vendimet të cilat i miratoi Këshilli Gjyqësor, lidhur me pikat të cilat ishin të mbyllura për publikun, përgjigjet nuk e kënaqën publikun dhe prandaj në media mbizotëroi një qëndrim negativ për punën e KGJRM.

Duke e pasur parasysh se mbledhjet e mbyllura, sipas ligjit parashikohen vetëm për shkak të mbrojtjes së integritetit dhe reputacionit të gjyqtarit i cili vlerësohet, duhet të rishikohet përjashtimi i publikut në rastet kur vet gjyqtari kërkon procedurë transparente, meqë përmes sigurimit të transparencës Këshilli Gjyqësor do të mbrohet nga spekulimet, ndërsa publiku do të jetë dëshmitar i punës profesionale të KGJRM.

## Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	
Raporte vjetore	Sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, Këshilli Gjyqësor harton Raport vjetor për punën e vet. Këshilli Gjyqësor duhet t'ia paraqes Raportin Kuvendit të RM-së për shqyrtim dhe miratim. Këshilli Gjyqësor Raportin duhet t'ia dërgoj të gjitha gjykatave në RM. Raporti duhet të jetë publik.

Këshilli Gjyqësor për vitin 2015 ia paraqiti Raportin Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Për Raportin nuk janë zhvilluar diskutime esenciale. I njëjti është publikuar në: [www.sud.mk](http://www.sud.mk).

Raporti për vitin 2016 duhet të hartohet nga Këshilli Gjyqësor deri në muajin mars të vitit 2017.

## EFEKTIVITETI NË PUNËN E KGJRM

### Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor e përcakton numrin e vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë, duke e marrë parasysh numrin e përgjithshëm të vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore, si dhe projeksionin e nevojave të vendeve të cilat do të plotësohen pas përfundimit të trajnimit fillestar.

Këshilli zgjedh gjyqtar të gjykatës themelore nga rangu i Listës së kandidatëve të paraqitur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të cilët kanë aplikuar në konkurs.

Në këtë periudhë nuk ka zgjedhje të gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe gjykatat më të larta.

### Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Zgjedhja:	Ushtuesi i detyrës së Gjykatës Supreme të RM, Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe i Gjykatës Themelore Gjevgjeli
Lista e kriterëve	<p>1. Kryetari i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, sipas kushteve, në procedurë dhe në mënyrë siç bëhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën përkatëse.</p> <p>2. Evaluimi i programit për punën e kandidatit për kryetar (Kandidati për kryetar të gjykatës aplikimit dhe dokumenteve tjera ua bashkëngjitë programin e punës për mandatin.)</p>
Vërejtje të përgjithshme	<p>Për shkak të skadimit të mandatit të kryetarëve të Gjykatës Supreme të RM, Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe Gjykatës Themelore Gjevgjeli, Këshilli Gjyqësor në fund të vitit 2016 e filloi procedurën për zgjedhjen e kryetarëve të rinj. Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat u mbajtën me 11 dhjetor, dhe sipas rekomandimit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit që të mos kryhet zgjedhja e kryetarëve në periudhën para zgjedhore, u caktuan vetëm UD kryetarë në këto gjykata.</p> <p>Për UD të Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqësor zgjodhi gjyqtaren e cila ka numër më të lartë të pikëve e cila është gjyqtare në Gjykatën Supreme vetëm dy muaj, vlerësimi është bërë për kohën kur ka qenë gjyqtare e Gjykatës së Apelit.</p> <p>Gjatë zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1, Këshilli Gjyqësor vetëm konstatoi se për UD kryetar të Gjykatës Themelore Shkup 1 zgjidhet gjyqtari me numër më të lartë të pikëve të fituara gjatë vlerësimit të fundit nga viti 2014.</p> <p>Këshilli Gjyqësor e bëri vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të gjykatave.</p> <p>Vlerësimi i jashtëzakonshëm është mundësi ligjore e Këshillit Gjyqësor, ndërsa mbledhjet gjatë vlerësimit të gjyqtarëve janë të mbyllura.</p> <p>Njëri nga kandidatët për kryetar të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup kërkoi që Këshilli Gjyqësor ta rishikoj vendimin për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të gjykatave. Këshilli Gjyqësor nuk e pranoi kërkesën, iniciativën e gjyqtarit e shpalli si të pabazë dhe konkludoi se nuk ka arsye për rishikimin e Vendimit për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës së Apelit Shtip, Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatës Themelore Tetovë (pika e rendit të ditës së mbledhjes në të cilën u shqyrtua kjo iniciativë nuk ishte e hapur për publikun).</p>



## Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave	
	Numri i procedurave
nëntor 2016 - janar 2017	1
Vërejtje të përgjithshme	Duke e pasur parasysh se vendimmarrjet për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit sipas Ligjit janë konfidenciale, të dhënat e vetme janë se Këshilli Gjyqësor, në këtë periudhë kohore, miratoi Vendim për përcaktimin e raportuesve nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM-së ndaj kërkesës së paraqitur për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.

## Zgjedhja e gjyqtarëve porotë

Zgjedhja e gjyqtarëve porotë	
Numri i konkurseve	Vendim për zgjedhjen e gjyqtarëve – porotë të Gjykatës Themelore Veles, Gjykatës Themelore Strumicë dhe Gjykatës Themelore Shtip, Vendim për zgjedhjen e gjyqtarëve – porotë të: Gjykatës Themelore Prilep, Vendim për zgjedhjen e gjyqtarëve – porotë të Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup, Vendim për zgjedhjen e gjyqtarëve – porotë në Gjykatën Themelore Radovish.
Numri i gjyqtarëve porotë	1173 gjyqtarë – porotë në përputhje me Vendimin e KGJRM për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve porotë në të gjitha gjykatat për vitin 2015
Numri i kandidatëve të paraqitur për gjyqtarë porotë brenda periudhës kohore (nëntor 2016 deri në janar të vitit 2017)	Gjykata Themelore Strumicë, të paraqitur 25, të zgjedhur 5 Gjykata Themelore Shtip, të paraqitur 17, të zgjedhur 16 Gjykata Themelore Prilep, të paraqitur 36, të zgjedhur 24 Gjykata Themelore Radovish, të paraqitur 3, të zgjedhur 3 Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup, të paraqitur 18, të zgjedhur 13
Vërejtje të përgjithshme	Në këtë periudhë kohore Këshilli Gjyqësor disa herë konstatoi zgjedhje dhe ndërprerje të funksionit të gjyqtarit porot në më shumë gjykata të shtetit. Si problem kryesor gjatë çdo zgjedhjeje konstatohet mungesa e gjyqtarëve porotë dhe numri i pamjaftueshëm i kandidatëve të cilët paraqiten në konkurse për zgjedhje të gjyqtarëve porotë.

Kriter për zgjedhjen e kandidatit për gjyqtar porot është të ketë kryer **arsim të lartë**, të ketë **reputacion** për ushtrimin e këtij funksioni dhe **të mos ketë më shumë se 64 vjet**. Gjyqtari – porot për gjykimin e të miturve zgjidhet nga radhët e personave me përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Gjyqtarët – porotë kanë **të drejtë kompensimi** për ushtrimin e punëve të gjyqtarit – porot e që është në lartësi prej 250 denarë për një ditë. Gjyqtari – porot zgjidhet për një periudhë **katërvjeçare** me mundësi për rizgjedhje.

Parashtrahet pyetja se sa është stimulues kompensimi në para i cili është më i ulët edhe nga pagesa ditore e pagës minimale, që të paraqiten persona të cilët kanë kryer arsim të lartë, dhe prandaj rekomandohet që Këshilli Gjyqësor të ketë një rol proaktiv në zgjidhjen e këtij problemi.

## Referimi i përkohshëm i gjyqtarëve

Referimi i përkohshëm i gjyqtarëve	
Numri i gjyqtarëve të referuar përkohësisht	Numri i gjyqtarëve të referuar përkohësisht jo më gjatë se 1 vit
	Gjatë kësaj periudhe 10 gjyqtarë janë referuar përkohësisht
Sa prej referimeve të përkohshme kanë qenë kundër vullnetit të gjyqtarëve	Nuk ka informacione për referim të përkohshëm kundër vullnetit të gjyqtarit i cili është paraqitur në Këshillin Gjyqësor.
Vërejtje të përgjithshme	Për shkak të mospasjes së numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykatat themelore, ndërkaq për shkak të vendeve të zbrazura të gjyqtarëve në disa gjykata themelore, Këshilli Gjyqësor, në drejtim të plotësimit të vendeve vakante të gjyqtarëve dhe krijimin e mundësive për punë me azhuret të gjykatave themelore, duhet medoemos të bëjë referime të përkohshme të gjyqtarëve nga një gjykatë themelore në gjykatë tjetër për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

**Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor:**

Propozojmë përditësim më të shpejtë të ueb faqes së re për qasje më të lehtë deri te të gjitha informacionet relevante për punën e tyre.

Këshilli Gjyqësor i RM-së në të ardhmen duhet të ketë një rol më të madh proaktiv në drejtim të sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit, jo vetëm t'i zbatoj ligjet, por duhet të ketë një rol më të madh në krijimin e politikave për një gjyqësor funksional të pavarur dhe të paanshëm.

## TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT

### Ueb lokacioni informativ i Këshillit të Fakteve dhe sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë

Ueb lokacioni informativ i Këshillit të Fakteve

Këshilli i fakteve **nuk ka ueb faqe të vet** meqë Këshilli Gjyqësor Buxhetor nuk ka realizuar prokurim përkatës për këtë çështje, madje edhe njoftimet nuk i publikon përmes ndonjë medie tjetër. Për këtë shkak, Rregullorja e punës e këtij organi, si dhe aktet e tjera nënligjore **nuk janë lehtë të aksesshme për publikun**<sup>3</sup> edhe pse këtij organi i është besuar roli që t'i shqyrtojë veç e veç të gjitha ankesat dhe parashtresat e parashtuara nga qytetarët, personat juridikë, kryetarët e gjykatave për punën e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave, si dhe për zvarritjen e procedurave gjyqësore, por edhe në bazë të zërit të dëgjuar apo në bazë të informatave të tjera për punën e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.

### Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë		
Karakteristika të përgjithshme për transparencën e institucionit	A ka KGJRM rregulla për komunikim me publikun	A ka person të angazhuar t'u përgjigjet kërkesave sipas qasjes së lirë deri te informacionet
	√	√

3 Rregullorja e punës së Këshillit të Fakteve është e aksesshme në "Gazetën Zyrtare të RM" numër 189 të datë 14.10.2016.

Informim proaktiv i publikut	Akte/të dhëna të publikuara integrale	Vërejtje të përgjithshme
Pres konferenca	×	Këshilli i Fakteve në këtë periudhë nuk ka caktuar pres konferencë për informimin e publikut
Njoftime	√x	Këshilli i Fakteve ka dërguar njoftime për publikun përmes mediave të cilat nuk janë transmetuar plotësisht.
Intervista dhe deklarata për media	√	Kryetari i Këshillit të Fakteve dha deklarata për media në lidhje me ngjarjet aktuale me iniciativat e parashtruara nga ana e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.

## EFEKTIVITETI NË PUNËN E KËSHILLIT TË FAKTEVE

### Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Këshilli i Fakteve **mban mbledhje më së paku një herë gjatë javës së punës**, në të cilën i shqyrton veç e veç të gjitha iniciativat dhe merr vendim.

Edhe pse sipas ligjit mbledhjet e Këshillit të Fakteve janë të hapura për publikun, publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit të Fakteve për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtarë, megjithatë, në praktikë **mbledhjet nuk janë publike**. Në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e punës **procedura për ngritjen e përgjegjësisë së gjyqtarit** është urgjente **me karakter konfidencial, zhvillohet pa prezencën e publikut** dhe respektohet reputacioni dhe dinjteti i gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, me ç'rast mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës konform akteve normative për mbrojtjen e të dhënave personale, përveç sipas kërkesës së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës me ç'rast Këshilli i Fakteve mund të marr vendim që procedura të zhvillohet me prezencën e publikut.

Në këtë periudhë është mbajtur vetëm **një mbledhje publike** sipas kërkesës së gjyqtarit për të cilin është paraqitur iniciativë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së tij.

### Procedura sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit pranë Këshillit të Fakteve

Procedura sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit pranë Këshillit të Fakteve			
	Nëntor	Dhjetor	Janar
Numri i parashtresave të paraqitura nga ana e qytetarëve, personave juridikë në nivel mujor	41	32	14
Mbledhje të mbajtura të Këshillit të Fakteve në të cilat janë shqyrtuar parashtresat e paraqitura	8	7	6
Kërkesa për ngritjen e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës pranë Këshillit Gjyqësor të RM	Është paraqitur një kërkesë pranë Këshillit Gjyqësor për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Këshilli i Fakteve akoma nuk ka informacione nëse Këshilli Gjyqësor e ka miratuar kërkesën.		

	Nëntor	Dhjetor	Janar
Aktivite sipas zërit të dëgjuar	Nuk kemi informacione për aktivitete plotësuese sipas zërit të dëgjuar.		
	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3
Kërkesë për ngritjen e përgjegjësisë sipas të dhënave nga zëri i dëgjuar	Për një lëndë të formuar sipas zërit të dëgjuar, Këshilli i Fakteve pranë Këshillit Gjyqësor të RM-së, paraqiti kërkesë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.		
Vërejtje të përgjithshme			

Këshilli i Fakteve akoma nuk ka informacione për atë nëse Këshilli Gjyqësor do të veprojë ndaj kërkesës së paraqitur për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.

Meqë Këshilli i Fakteve nuk ka ueb faqe të vet dhe madje dokumentet dhe aktivitetet e tij nuk i publikon në media të tjera, Instituti për të Drejtat e Njeriut paraqiti kërkesë për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik për numrin e parashtrësave – iniciativave të paraqitura nga ana e qytetarëve dhe personave juridikë për periudhën kohore nga muaji nëntor 2016 deri në muajin dhjetor të vitit 2017. Si përgjigje, informacionet i pranuan në kohë dhe të njëjtat janë prezantuar në tabelën më lartë.

#### Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e Këshillit të Fakteve:

Nevojitet që Këshilli i Fakteve të ketë ueb faqe të vet në të cilën do t'i publikojë aktivitetet e veta. Është e dobishme që Këshilli i Fakteve të përfshihet në platformën e përbashkët të re të gjyqësorit [www.sud.mk](http://www.sud.mk), e cila duhet t'i zëvendësoj ueb faqet ekzistuese të Këshillit Gjyqësor dhe të gjitha gjykatave në shtet. Këshilli i Fakteve, aktualisht, si organ i cili inicion procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, nuk guxon të anashkalohej nga kjo platformë interneti.

Veçanërisht është i rëndësishëm roli proaktiv i këtij organi për njoftimin e qytetarëve sa i përket ekzistimit të tij dhe kompetencës së tij që t'i pranojë iniciativat e qytetarëve dhe personave juridikë.

Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi aplikacion mobil për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor. Aplikacionin mund ta shkarkoni FALAS në Google Play Store dhe në Apple Store me emrin "Судски совет под лупа". Këtu do t'i gjeni të gjitha informacionet rrjedhëse dhe raportet tremujore të hartuara në kuadër të Projektit "Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM".

